Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot. 05/320/Do-230
Data 10.02.2015
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR / ZA / TO** | **Z. Avdullah Hoti Ministër i Financave** | **DATË DATUM DATE** | **10.02.2015** |
| | | **Reference** | |
| **NGA / OD / FROM** | **Besnik Bislimi, deputet iGP Lëvizja VETËVENDOSJE!** | | |
| **SUBJEKTI PREDMET SUBJECT** | **Pyetje për përgjigje me gojë** | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

## ÇËSHTJA

Më 05.02.2015, ju dolët para publikut me një vendim të cilësuar si një fillim të ri, përmes të cilit qytetarëve dhe bizneseve të vendit u falen borxhet e akumuluara deri në vitin 2008. Në listën e borxheve të falura janë futur obligimet e qytetarëve dhe bizneseve ndaj ATK-së, Doganave, Tatimit në Pronë dhe ndërmarrjeve shoqërore. Njëherit keni deklaruar se kjo është edhe masë me synim krijimin e një perceptimi të një jete më të mirë në Kosovë dhe do të ndal ikjet e mëdha nga Kosova.

## PYETJA

Duke qenë se secili vendim qeveritar duhet të përfshijë edhe analizën e ndikimit buxhetor, dua të di se a keni bërë paraprakisht ndonjë studim për të konkluduar mbi ndikimin e këtij vendimi në buxhetin e Republikës së Kosovës, shëndetin financiar të ndërmarrjeve publike të prekura nga ky vendim dhe Komunave në emër të të cilave keni falur borxhet, (përfshirë këtu edhe nivelin e borxheve të "falura" që janë të paarkëtueshmë ligjërisht) dhe mbi kanalet përmes të cilave mund të ndalen ikjet masive nëse bizneseve të papërgjegjshme ua falni obligimet doganore?